



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Plani i Zhvillimit Profesional për Stafin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (2026–2028)

¹ Plani i Zhvillimit Profesional për Stafin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim miratuar me Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Ref.:114/26, Datë:30.01.2026.

Vizioni

Agjencia e Kosovës për Akreditim është Agjenci e njohur ndërkombëtarisht e cila kontribuon në mënyrë të qëndrueshme në përmirësimin e cilësisë dhe në një sistem gjithëpërfshirës të arsimit të lartë në Kosovë, duke përgatitur individë që ndërtojnë karriera të suksesshme brenda dhe jashtë vendit dhe që reflektojnë zhvillim personal në përputhje me vlerat dhe aspiratat shoqërore.

Misioni

Mbështetë zhvillimin e cilësisë në sektorin e arsimit të lartë përmes sigurimit të jashtëm të cilësisë, duke e harmonizuar atë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Objektivat zhvillimore

Plani i Zhvillimit Profesional për Stafin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim është i strukturuar rreth katër objektivave kryesore zhvillimore të cilët lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e vizionit të strategjisë dhe zhvillimin e sistemit të sigurimit të jashtëm të cilësisë në Kosovë.

Katër objektivat zhvillimore janë:

1. Zhvillimi i AKA-së si institucion që pasqyron profesionalizëm të lartë dhe standarde etike në proceset e sigurimit të cilësisë në Kosovë.
2. Avancimi i praktikave të sigurimit të cilësisë për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë.
3. Ndërkombëtarizimi i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe shfrytëzimi i tij për të avancuar praktikatat institucionale dhe ato në nivel sistemi.
4. Promovimi i kulturës së cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë përmes vetëdijesimit individual dhe institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe praktikave të institucionalizuara.

Qëllimi

Ky dokument shërben si udhërrëfyes strategjik për zhvillimin profesional të stafit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tre vitet e ardhshme, ku synon rritjen e kapaciteteve profesionale, teknike dhe menaxheriale të stafit, duke siguruar përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë.

1. Objektivat Kryesore të Zhvillimit Profesional

- Rritja e kompetencave profesionale në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë në vendin e punës;
- Diversifikimi i njohurive të stafit përtej përshkrimit të detyrave të pozitës;
- Avancimi i njohurive për përdorimin e platformave dhe datbazave të AKA-së dhe përdorimi i të dhënave për analiza dhe planifikim;

- Avancimi i vazhdueshëm i aftësive të komunikimit profesional me IAL-të dhe palët e interesit;
- Përgatitja e stafit për përfaqësim dhe prezantim brenda dhe jashtë vendit;
- Avancimi i njohurive të stafit në aspektet ligjore, financiare dhe administrative;
- Zhvillimi i njohurive mbi praktikat më të mira europiane në sigurimin e cilësisë;
- Ngritja e kapaciteteve në draftimin dhe menaxhimin e raporteve dhe analizave.

2. Kompetencat e Synuara;

2.1 Kompetenca Profesionale

- Analiza e dokumenteve të akreditimit, pas-akreditimit dhe monitorimit;
- Kuptimi dhe aplikimi i standardeve ESG dhe legjislacionit të AKA-së;
- Hartimi i raporteve të bazuara në evidencë;
- Hartimi dhe draftimi i akteve administrative dhe nënligjore;
- Aftësimi për përfaqësim dhe prezantim të AKA-së brenda dhe jashtë vendit.

2.2 Kompetenca Teknike

- Përdorimi i databazave të AKA-së dhe platformës e-akreditimi;
- Menaxhimi i të dhënave dhe validimi i informacionit institucional;
- Aplikimi i instrumenteve ligjore për ngritje të cilësisë.
- Aftësi për të kuptuar dhe interpretuar akte ligjore dhe nënligjore, dhe për përfaqësim ligjor.
- Përditësim i vazhdueshëm me zhvillimet e reja në fushën e financave, burimeve njerëzore dhe administrates.

2.3 Kompetenca Komunikuese

- Komunikim profesional me IAL-të dhe palët e tjera të interesit;
- Prezentim dhe adresim i qartë i gjetjeve dhe rekomandimeve;
- Menaxhim i situatave sfiduese gjatë vizitave në terren;
- Përdorim i drejtë dhe sipas rregullave të mjeteve të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Administrim dhe adresim i drejtë i informatave dhe të dhënave konfidenciale.

2.4 Kompetenca të Zhvillimit Organizativ:

- Punë ekipore dhe koordinim;
- Menaxhimi i burimeve, kohës dhe prioriteteve;
- Gatishmëri për përmirësim të vazhdueshëm;
- Planifikimi afatshkurtër dhe afatmesëm.

3. Aktivitetet e Planit të Zhvillimit Profesional të stafit të AKA-së të ndara nëpër vite

Objektivat Strategjik	Punëtori/ Trajnim	Pjesëmarrës	Kosto	Bartës i aktivitetit	Afati kohor
Objektivi 1: Zhvillimi i AKA-së si institucion që pasqyron profesionalizëm të lartë dhe standarde etike në proceset e sigurimit të cilësisë në Kosovë.	Punëtori me stafin e Agjencisë mbi nevojat dhe prioritetet e zhvillimit profesional	Të gjithë zyrtarët e AKA-së	Shpenzime administrative	Divizioni i për shërbime të përgjithshme	2026
	Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit në fushën e etikës dhe integritetit profesional	Te gjithë zyrtarët e AKA-së	1000 EU	Divizioni i për shërbime të përgjithshme	2026
	Punëtori mbi përcaktimin e ndarjes së detyrave dhe hartimin e protokollit të përgjegjësie	Menaxhmenti i lartë, i mesëm dhe i ulët	3000 EU	Divizioni i për shërbime të përgjithshme	2026
	Trajnime të ofruara nga IKAP	Varësisht nga lloji i trajnimit të ofruar, do të caktohen stafi për pjesëmarrje në trajnim	Shpenzime administrative	Divizioni përkatës	2026 2027 2028
	Trajnim praktik në përdorimin e platformës e-akreditimi.	Stafi i ri i AKA-së	Shpenzime administrative	Zyrtari i IT	2026
	Trajnim praktik mbi zhvillimin e planeve të punës në bazë të objektivave të divizionit dhe departamentit.	Gjithë stafi i AKA-së	Shpenzime administrative	Divizioni për shërbime të përgjithshme	2026
	Trajnim për përmirësimin e kapaciteteve të AKA-së në menaxhim, lidrship dhe	Stafi përgjegjës për detyrat specifike	5000 EU	Ekspert apo kompani që ofron trajnime të tilla	2026

	menaxhimin e ndryshimeve				
	Pjesëmarrje në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare të QA	Të gjitha departamentet/divizionet	160. 000 EU	Drejtori i përgjithshëm, udhëheqësit e departamenteve/divizioneve	2026, 2027, 2028
Objektivi 2: Avancimi i praktikave të sigurimit të cilësisë për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë.	Punëtori mbi analizën e RVV-ve të institucioneve dhe programeve të studimit	Divizioni për akreditim, monitorim dhe pasakreditim	Shpenzime administrative	Manaxhmenti i departamentit për vlerësim dhe akreditim	2026, 2028
	Trajnimi orientues për anëtarët e rinj të KSHC-së, stafin e ri të AKA-së dhe Komisionin e Ankesave	Anëtarët e rinj të KSHC-së, Komisionin e Ankesave dhe stafit të ri të AKA-së	Shpenzime administrative	Divizioni për shërbime të përgjithshme	Sipas nevojës
	Punëtori për krijimin e modelit të mësimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë	Koordinatorët e cilësisë së IAL-ve	1000 EU	Menaxhmenti i AKA-së	2026
	Modeli i mësimit të ndërsjellë i përgatitur	AKA	Shpenzime administrative	AKA	2026
	Punëtori për raportimin e aktiviteteve sipas planit të performancës	AKA	Shpenzime administrative	AKA	2026
	Punëtori për hartimin e tre procedurave standarde operacionale	AKA	8000	AKA	2026
	Punëtori për procedurat e mentorimit të stafit të ri për sistemin e vlerësimit	AKA	Shpenzime administrative	AKA	2026, 2027, 2028
	Punëtori mbi metodologjinë e vizitave të monitorimit	Të gjithë zyrtarët e divizionit të monitorimit	Shpenzime administrative	Divizioni i monitorimit	2027

	Punëtori mbi trendët e reja në sigurimin e cilësisë dhe/ose standardet ESG	AKA	Shpenzime administrative	AKA	2027
	Punëtori për hartimin e analizave tematike	AKA	Shpenzime administrative	AKA	2026
	Hartimi i modeleve të reja të monitorimit bazuar në analiza	Të gjithë zyrtarët e divizionit të monitorimit	Shpenzime administrative	Drejtori i departamenti t për monitorim dhe pasakreditim	2028
Objektivi 3: Ndërkombëtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe shfrytëzimi i tij për të avancuar praktikatat institucionale dhe ato sistemore.	Gjashtë (6) punëtori online të organizuara nga CEENQA	Të gjithë zyrtarët e AKA-së	Shpenzime administrative	Divizioni i Burimeve Njerëzore	2026 2027 2028
	Pjesëmarrja e dy anëtarëve të stafit në ngjarjet vjetore të EQAR-it	Nga divizione të ndryshme	3000	Menaxhmenti	2026 2027 2028
	Pjesëmarrja e një anëtari në programin e lidërshpit të ENQA-s	Menaxhmenti i ulët	9000 EUR	Menaxhmenti i lartë	2027
	Trajnime të tjera ndërkombëtare në fushën e sigurimit të cilësisë dhe peer learning	Një zyrtar i AKA-së	10. 000 EUR	Menaxhmenti i lartë	2026 2027 2028
Objektivi 4: Promovimi i kulturës së cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë përmes vetëdijesimit individual dhe institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe praktikave të institucionalizuara.	Vizita vlerësuese me Departamentin për Vlerësim dhe Akreditim	Zyrtaret nga divizioni i monitorimit dhe pasakreditimit	Shpenzime administrative	Departamenti për vlerësim dhe akreditim	2026 2027 2028
	Punëtori për rishikimin vjetor të formularëve të monitorimit dhe pasakreditimit	Zyrtaret nga divizioni i monitorimit dhe pasakreditimit	Shpenzime administrative	AKA	2027
	Punëtori mbi analizën e të dhënave dhe përdorimin e tyre në politikë bërje	Gjithë stafi i AKA-së	9000 EU	AKA	2026 2027 2028

4. Trajnime dhe aktivitete shitesë për zhvillimin profesional të stafit të AKA-së

Përveç trajnimeve specifike profesionale, stafi i AKA-së do të marrin edhe Trajnime të brendshme të organizuara nga AKA, trajnime të jashtme në bashkëpunim me ENQA, EQAR, CEENQA dhe partnerë të tjerë, mësim ndërkolegial (peer learning) brenda institucionit dhe në institucione tjera jashtë vendit.

5. Monitorimi dhe Vlerësimi i Progresit

- Vlerësim vjetor i kompetencave të stafit;
- Identifikimi i boshllëqeve dhe përshtatja e planit;
- Raport vjetor mbi aktivitetet e zhvillimit profesional;
- Reflektim i arritjeve në objektivat e agjencisë.

6. Përfundim

Ky model tre vjeçar i zhvillimit profesional do të ndihmojë stafin e AKA-së të fuqizojë rolin e tij në sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, duke siguruar që stafi të jetë i përgatitur, kompetent dhe në linjë me Strategjinë e AAK-se dhe me kërkesat bashkëkohore ndërkombëtare të ngritjes së cilësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:114/26, Datë: 30.01.2026

Në mbështetje të nenit 20, të Ligjit Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 13/ 29 qershor 2023), nenit 22, 23 dhe 25 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si dhe Planin Strategjik të AKA-së 2026-2030, Drejtori i Përgjithshëm merr:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani i Zhvillimit Profesional për Stafin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (2026–2028).
- II. Plani hyn në fuqi me nënshkrimin të këtij vendimi.

A R S Y E T I M

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, është hartuar Plani i Zhvillimit Profesional për periudhën 2026–2028. Ky dokument përcakton prioritetet, objektivat dhe aktivitetet konkrete për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Përmes këtij plani synohet avancimi i kompetencave profesionale, teknike dhe organizative të stafit, si dhe përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës në realizimin e funksioneve të agjencisë. Miratimi i këtij dokumenti krijon një kornizë të strukturuar për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve zhvillimore dhe për monitorimin e progresit të tyre. Për rrjedhojë, miratimi i këtij plani konsiderohet i domosdoshëm për realizimin e objektivave strategjike të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, konform Planit Strategjik të AKA-së 2026-2030 .

Naim Gashi

Vendimi iu dërgohet:

- Arkivit të AKA


Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia e Kosovës për Akreditim

